VENDIM
Nr. 346, datë 29.12.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DISA NDRYSHIME NË TREGUESIT E KRITEREVE STANDARDE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 7, pika 1; 16; 19, germat "h" dhe "j", dhe nenit 20, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 19, germa "f" dhe 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimit dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Konsumatore dhe Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, me nr. 3147 prot., datë 24.12.2025, "Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në treguesit e kritereve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Kuvendi i Shqipërisë në Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2024, miratuar në datën 9.10.2025, ka rekomanduar marrjen e masave për rishikimin e rregullave dhe standardeve të cilësisë së shërbimit të ofruar nga operatorët e rrjetit, në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të cilësisë për konsumatorët e energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, ka miratuar "Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike", e cila përcakton ndër të tjera treguesit e cilësisë së furnizimit me energji elektrike dhe performancën, në lidhje me sigurinë e rrjetit për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike (OSSH) sh.a.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 97, datë 7.4.2021, ka miratuar treguesit për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021.
- Në zbatim të detyrimit për raportim, "OSSH" sh.a. ka përcjellë periodikisht raportimet mbi standardet e arritura të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes, ndërsa nga të dhënat e raportuara për 9-mujorin (janar–shtator) 2025 rezultojnë tendenca për përmirësim të treguesve kryesorë të cilësisë së shërbimit, përfshirë energjinë e pafurnizuar (ENS) dhe treguesit SAIDI dhe SAIFI.
- Në vijim të komunikimit, "OSSH" sh.a., me shkresën nr. 2717/2 prot., datë 12.11.2025, ka bërë me dije arsyet që lidhen me përmirësimin e treguesve të cilësisë së shërbimit, si dhe pritshmëritë për vijimin e trendit përmirësues për vitin 2025 dhe vitet pasardhëse, ndërkohë që ka bërë me dije edhe procesin e hartimit të Kodit të Shpërndarjes.
- Duke pasur parasysh realizimet e deritanishme dhe pritshmëritë afatmesme pozitive, si dhe faktin se miratimi i një Kodi të ri Shpërndarjeje mund të kërkojë kohë, ERE, bazuar në nenin 13 të rregullores së miratuar me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, me iniciativën e saj, vlerëson se është në rrethanat që mund të procedojë me fillimin e procedurës për ndryshimin e treguesve të kritereve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe rishikimin e disa dispozitave të kësaj rregulloreje që, për shkak të implementimit ndër vite apo humbjes së aktualitetit, rezultojnë të nevojshme për t'u rivlerësuar.
- Në vijim të rishikimit të "Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit", konstatohet se kompensimi i klientëve fundor, në rast të mosrespektimit të këtyre kritereve, realizohet përmes marrëdhënies kontraktuale ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesit, e rregulluar nga "Marrëveshja për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë

elektrike", e miratuar nga Bordi i ERE-s; për këtë arsye, pika 10.2, e nenit 10 të kësaj rregulloreje harmonizohet me këtë akt kontraktual, me qëllim garantimin e qartësisë juridike dhe koherencës rregullatore në zbatimin e mekanizmit të kompensimit ndaj klientëve fundor.

- Treguesit aktualë të standardeve teknike (p.sh. koha mesatare e ndërprerjes, energjia e pafurnizuar – ENS, indekset SAIDI/ SAIFI), të përcaktuar në vendimet e mëparshme të Bordit, kanë treguar ndryshime në performancë dhe tregojnë nevojën për përshtatje të vlerave objektive të standardeve për të reflektuar realitetin e tregut dhe performancën e operatorëve.

- Rregullorja aktuale përmban dispozita që kanë humbur aktualitetin ose janë bërë të papërshtatshme për situatën operacionale, përfshirë dispozita të caktuara që parashikojnë afate, raporte ose kërkesa që nuk korrespondojnë me zhvillimet e sektorit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për disa ndryshime në "Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, të ndryshuar.

2. Fillimi i procedurës përfshin shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për rishikimin e rregullores dhe aneksit të "Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike", në lidhje me parametrat e treguesve të cilësisë së shërbimit, sipas tabelës së standardeve të cilësisë, si më poshtë:

A- Drafttreguesit e cilësisë së shërbimit për vitet 2026, 2027, 2028:

Treguesit	Njesia	Propozim Vitet 2026		2027		2028	
a. Energjia e pafurnizuar (ENS)	MWh	33,318		32,651		31,998	
f. SAIDI	Ore	38.20		36.29		34.48	
g. SAIFI	numer	23.52		22.56		21.65	
h. Koha e nevojshme per riparimin e sherbimit pas nje difekti ne sistemin e shperndarjes (TM+TU)	Ore	1.79		1.77		1.75	
		Urbane	Rurale	Urbane	Rurale	Urbane	Rurale
TM 35kV	ore	1.58	1.97	1.57	1.93	1.56	1.89
20 kV	ore	1.23	1.64	1.22	1.62	1.21	1.60
6-10 kV	ore	2.35	2.88	2.33	2.85	2.31	2.82
0.4 kV	ore	1.00	1.14	0.99	1.12	0.98	1.10

- B- Në rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, të ndryshuar fillojnë procedurat për ndryshimet, si vijon:

- B-1 Neni 6 të shfuqizohet;

- B-2 Paragrafi i fundit, i pikës 7.1, të nenit 7 të ndryshojë dhe të bëhet: "Nivelet e pritshme të performancës, siç miratuar nga ERE, do të vihen në zbatim menjëherë dhe do të mbeten në fuqi, deri në rivlerësimin e këtyre standardeve nga ERE në funksion të performancës së matur dhe të raportuar.";

- B-3 Pika 7.2, e nenit 7 të shfuqizohet;

- B-4 Pika 7.3, e nenit 7, të ndryshojë dhe të bëhet: ""OSSH" sh.a. ose ERE, me iniciativën e saj, do të propozojë dhe ERE do të miratojë nivelin e lejuar të rishikuar të kritereve standarde të cilësisë së shërbimit në funksion të performancës së matur dhe të raportuar.";

- B-5 Pika 7.4, e nenit 7, të ndryshojë dhe të bëhet: "Jo më vonë se njëherë në 3 vjet ERE do të rishqyrtojë performancën e arritur gjatë kësaj periudhe, do të rivlerësojë nivelet e pritshme të

performancës dhe do të miratojë nivelin e lejuar të kritereve standarde të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e shpërndarjes.";

- Pika 10.2, e nenit 10, të ndryshojë dhe të bëhet: "Kompensimi i klientëve fundor të lidhur në rrjetin e shpërndarjes, në rast të mosrespektimit të kritereve standarde të cilësisë së shërbimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, do të bëhet bazuar në përcaktimet e "Marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit", të miratuar nga Bordi i ERE-s.".

3. Drejtoria e Çështjeve Konsumatore të njoftojë shoqërinë "OSSH" sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti